



Reagim i përbashkët

Prizren, 22 tetor 2012

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe) nga afër kanë përcjellë procesin e hartimit dhe të miratimit të rregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje nga Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Konstatimi i përbashkët i këtyre dy organizatave që monitorojnë legjislativin dhe ekzekutivin e komunës së Prizrenit është se procesi ka pasur defekte serioze, ngase pikësëpari nuk janë respektuar udhëzimi administrativ i MAPL-së (2008/09) dhe vet statuti i komunës së Prizrenit, për organizimin e diskutimit publik në lidhje me përmbajtjen e rregullores së lartëpërmendur.

Monitoruesit e KDI-së dhe të EC Ma Ndryshe shprehin shqetësimin e tyre me praktikën e fundit të ekzekutivit dhe legjislativit të Prizrenit që një rregullore kaq e ndjeshme dhe e rëndësishme për zhvillimin e gjithmbarshëm të kaloj pa u vënë në sprovën e publikut, respektivisht pa u testuar nëse është në interesin e qytetarëve apo jo, përmes debatit të mirëfilltë publik.

KDI dhe EC Ma Ndryshe, duke marrë parasysh rrjedhën e procesit dhe zhvillimet aktuale në komunën e Prizrenit, konsiderojnë se miratimi i shpejtë i kësaj rregulloreje është përpjekje e zyrtarëve të lartë komunal për lirim/amnistim nga përgjegjësitë që kanë por edhe krijimin e mundësive për shkelësit e ligjit që të legalizojnë aktivitetin e tyre ilegal, të deritanishëm.

Regullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje nuk i përcakton në mënyrë strikte kushtet për legalizim të ndërtimeve pa leje dhe kjo më së miri vërehet në nenin 13.3 ku thuhet se "DUPH-ja dhe grupi i ekspertëve do të përgatisin një manual për standarde minimale për legalizim". Po ashtu rregullorja nuk përcakton se çfarë do të ndodh me ndërtimet pa leje që nuk do të legalizohen. Prandaj KDI dhe EC Ma Ndryshe shprehin bindjen se kjo rregullore është selektive, që favorizon grupe të caktuara të interesit dhe që nuk i shërben interesave publike.

Madje këto konstatime janë dëgjuar edhe nga vet këshilltarët e KK-së, të cilët kanë pranuar se çdo etiketim është i përshtatshëm për këtë rregullore, duke mos përjashtuar as dyshimet për korrupsion. Ndërkohë është pranuar se rregullorja në fjalë është kopje e rregullores së komunës së Prishtinës në masën 95 për qind, që gjithashtu nuk është e drejtë karshi qytetarëve të Prizrenit ngase kryeqyteti dhe Prizreni kanë specifika, nevoja dhe realitet tjetër sa i përket sektorit të urbanizimit.

KDI dhe EC Ma Ndryshe kërkon nga MAPL-ja që të kthej në KK për rishqyrtim këtë rregullore, me qëllim që të organizohet debati publik, ndërkohë që nga MMPH-ja kërkon që kjo rregullore

të mos miratohet dhe të kthehet për precizimin e të gjitha kushteve dhe kriterëve për legalizim dhe masat që duhet ndërmarrë për objektet që nuk legalizohen.

Ndërkohë shoqëria civile do të shqyrtoj edhe mundësinë e që kjo rregullore t'i nënshtorhet referendumit në përputhje me nenin 71 të LVL-së, në mënyrë që qytetarët e komunës së Prizrenit të vendosin në mënyrë të drejtëpërdrejtë për këtë çështje.

Pos, kësaj KDI dhe EC Ma Ndryshe shprehin shqetësimin për mospërfilljen e dispozitave të Ligji mbi partneritetet publiko-private dhe koncesionet në infrastrukturë, ku Kryetari i komunës së Prizrenit ka shkelur parimet bazë të këtij ligji ngase ofertat për hyrje në partneritet publiko-privat kanë ardhur nga investuesit e ndërtimeve kolektive pas fillimit të punimeve, ndërkohë që një gjë e tillë është miratuar edhe nga kuvendarët e KK-së, në seancën e fundit.